

**Nr. Prot. 084/B/19****VENDIM Nr. 1420****Për****‘Vazhdimin e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve Frekuencore****2x10 MHz (905 - 915 & 950 - 960 MHz) në brezin 900 MHz****dhe****2x20 MHz (1710 - 1730 MHz & 1805 - 1825 MHz) në brezin 1800 MHz****për operatorin IPKO Telecommunications LLC’**

Në mbështetje të nenit 3, nenit 9, paragrafi 3), nën-paragrafët 3.3), 3.5), 3.6) dhe 3.7), nenit 10, paragrafët 12) dhe 14), nenit 45 paragrafi 1) dhe 2), neni 46, paragrafi 1), paragrafi 2.2) dhe paragrafi 5), neni 47, paragrafi 1) dhe paragrafi 4), neni 48 paragrafi 1.1), nenit 49, paragrafi 1.2), neni 54 paragrafi 2, nenit 79 paragrafi 1) dhe paragrafi 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si; Ligji ose LKE*); Neni 9) paragrafi 9.4.1), neni 14 paragrafi 14) nën-paragrafi 14.1) dhe nën-paragrafi 14.6.4) i Rregullores Nr. 22 për Dhënien dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuencave; Neni 5 të Rregullores Nr. 35 për “Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave; Planit Kombëtar të Shpërndarjes së Spektrit Frekuencor i miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas vendimit Nr. 04-V-93, dt. 23 Qershor, 2013 (*Tabelës së Shpërndarjes dhe shfrytëzimit të radio frekuencave*); Planit e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz të miratuar me Vendimin nr.1337 (*Ref. Nr.Prot.022/B/19*); Planit për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT ”(*Ref. Nr. Prot. 047/B/19 Dt. 08/05/2019*); Dokumentit “Konkluzionet e ARKEP - Ripërtrirja e autorizimeve individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz për operatorët “Telekomi i Kosovës” SH.A. dhe IPKO Telecommunications LLC (*Ref. Nr.Prot.066/B/19*); Vendimit Nr.452 (*Ref. Nr.Prot.002/B/14; dt.13/02/2014*) për kufizimin e numrit të autorizimeve për shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike-Radio Frekuencat; Vendimit Nr.400 (*Ref.Nr.Prot.031/B/13; dt.04/10/2013*) për liberalizimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra përmes lejitimit të përdorimit të teknologjive të reja që mundësojnë shërbimet e avancuara mobile brezgjëra; si dhe në bazë të nenit 13, paragrafët 1) dhe 5) të Statutit (*Ref. Nr. Prot. 161/06*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i ARKEP i përbërë nga;

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli, Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 43-të me radhë të mbajtur më datë 25 Korrik 2019, në përmbyllje të procedurës për ripërtrirjen e autorizimit për ripërtrirjen e autorizimit për kapacitetet frekuencore në brezet 900 dhe

1800 MHz, pas shqyrtimit të aplikacionit të operatorit IPKO Telecommunications LLC (Ref. Nr.Prot.422/2/19; dt.11/07/2019), si dhe rekomandimit të Komisionit të ARKEP të themeluar me Vendimin nr.1382 (Ref. Nr.Prot.052/B/19), Bordi i ARKEP Vendosi si më poshtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e IPKO Telecommunications LLC për ripërtrirjen e autorizimit për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të radio spektrit frekuencor me kapacitetet si në vijim:
  - a) **2x10 MHz në kuadër të brezit frekuencor 900MHz (905 - 915 & 950 - 960 MHz);**
  - b) **2x10 MHz në kuadër të brezit frekuencor 1800 MHz (1710 - 1720 & 1805 - 1815 MHz);**
  - c) **2x10 MHz në kuadër të brezit frekuencor 1800 MHz (1720 - 1730 & 1815 - 1825 MHz);**
- II. Resurset frekuencore të specifikuara në pikën I) të këtij vendimi caktohen në shfrytëzim sipas parimit të neutralitetit teknologjik dhe do jenë në dispozicion për shfrytëzim efektiv komercial për periudhën 20 vjeçare:
  - a) Resurset frekuencore të specifikuara në paragrafët I. a) dhe b) do të jenë në dispozicion për shfrytëzim nga data **07 Mars, 2022** deri më **06 Mars, 2042**.
  - b) Resurset frekuencore të specifikuara në paragrafin I. c) do të jenë në dispozicion për shfrytëzim nga data **31 Korrik, 2019** deri më **30 Korrik, 2039**.
- III. Obligohet operatori IPKO Telecommunications LLC që për shfrytëzimin e resurseve frekuencore të caktuara në pikën I) të këtij vendimi të zbatojë kushtet dhe kriteret e përcaktuar në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
- IV. Obligohet operatori IPKO Telecommunications LLC që në emër të vazhdimit të shfrytëzimit të blloqeve frekuencore të caktuara në pikën I) të këtij vendimi, si dhe me kohëzgjatje sipas pikës II) të këtij vendimi, të kryejë pagesat sipas vlerave dhe mënyrës së përcaktuar në Shtojcën I të këtij Vendimi.
- V. Miratohet SHTOJCA I - Autorizimi Individual për Vazhdimin e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz për operatorin IPKO Telecommunications LLC.
- VI. Ky vendimi është përfundimtar dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIMI

Neni 1 i LKE-së përcakton se: “Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Po ashtu neni 3, paragrafi 1) i LKE-së specifikon që: “Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike duhet të bazohet në parimet e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të burimeve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kriterëve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mos diskriminim.”

Më tutje neni 10 i LKE-së definojnë kompetencat e ARKEP në kuadër të së cilave është edhe menaxhimi i resurseve të fundme: spektri i radio frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike, që në mënyrë detajuar është specifikuar në Kapitullin VII të LKE-së.

Në mënyrë të veçantë, në nenet 46 deri 51 të LKE-së është përcaktuar procedura e dhënies në shfrytëzim të resurseve të kufizuara. Neni 48 i LKE-së ka përcaktuar 3 mënyra të dhënies së resurseve të kufizuara: dhënia e drejtpërdrejtë, përmes tenderit dhe ankandit, kurse neni 54 përcakton kushtet për shfrytëzimin e radio- frekuencave (kanaleve).

Marrë parasysh faktin se IPKO Telecommunications LLC si operator ekzistues e ka të shtrirë rrjetin e tij në tërë territorin e Republikës së Kosovës, mund të konkludohet se shfrytëzimi i spektrit frekuencore në kapacitet ekzistues frekuencore është duke u bërë në mënyrë efikase.

Prandaj, në përputhje me rekomandimin e kompanisë konsulente, komentete të pranuar nga operatorët, si dhe me qëllim të ruajtjes së kontinuitetit të ofrimit të shërbimeve për përdoruesit fundorë, ruajtjes së konkurrencës, ARKEP duke marrë si bazë çmimin “One-Off” të përcaktuar si pjesë të procesit të konsultimit publik do t’i ripërtërije autorizimin individual për operatorin në fjalë sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke mundur vazhdimin e shfrytëzimit të këtyre kapaciteteve frekuencore.

Për më tepër, dhënia e drejtpërdrejtë është e përshtatshme pasi që këto dy breze frekuencore janë esenciale për IPKO Telecommunications LLC. që të vazhdojë të ofrojë shërbimet e tyre për përdoruesit fundorë. Në anën tjetër ky operator nuk ka breze alternative për të përmbushur kërkesat e përdoruesve të tyre. Dhënia e këtyre resurseve frekuencore përmes ankandit ose tenderit (Beauty Contest) do të ndikonte në pasigurinë dhe rrezikun potencial që operatori në fjalë mund të humb një pjesë të spektrit të saj, e cila nga ana tjetër do të kishte një ndikim negativ në cilësinë e shërbimit. Pasiguria mund të pengojë gjithashtu investimet nga operatori në shtrirjen e rrjetit dhe vendosjen e shërbimeve të reja, të cilat mund të kenë një ndikim të dëmshëm në këtë sektor, duke shkaktuar probleme serioze ekonomike dhe sociale.

Në anën tjetër, dokumenti i miratuar nga QeK "Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike-Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020' (tutje referuar si - *Politikat e Sektorit*) në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike ka përcaktuar objektiven si në vijim:

“Objektivi i parë është që të sigurohet zhvillim konsistent në kuptimin gjeografik i rrjeteve të komunikimeve elektronike brez gjëra (broadband) në tërë territorin nacional dhe promovimi i përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike (“Objektivi 1 i Prioritetit 1”).”

Në mënyrë specifike Politikat e Sektorit kanë përcaktuar që deri në fund të vitit 2020, rreth 100% e qytetarëve/konsumatorëve duhet të kenë qasje në shërbimet brez gjëra me shpejtësi së paku 30 Mbps.

Rregullorja nr. 22 për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave (*Ref. Nr. Prot. 054/B/13*), neni 9 (Vazhdimi i periudhës së vlefshmërisë për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave), paragrafi 9.4.1 përcakton si në vijim: “Të vazhdohet periudha kohore e vlefshmërisë për shfrytëzimin e radio frekuencave në rast se shfrytëzuesi i ka respektuar kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave për tre vitet e kaluara dhe ekziston njëri nga rastet e mëposhtme.

Neni 9.4.1.2 përcakton që: “Radio frekuencat për të cilat është pranuar kërkesa për vazhdim të periudhës kohore të shfrytëzimit, janë përdorur për ofrimin e komunikimeve në rrjete publike dhe ndryshimi i shfrytëzuesit të këtyre radio frekuencave mund të ngrit probleme serioze ekonomike, sociale apo aktivitete të ndërlydhura tek shfrytëzuesit e rrjetit publik telekomunikuese dhe/apo shërbimeve të komunikimeve elektronike. Ky paragraf do të jetë i aplikueshëm vetëm në rast kur kushtet e tjera nuk janë ndryshuar gjatë ndërrimit të periudhës kohore për shfrytëzim të radio frekuencave.”

Me Vendimin nr. 452 (*Ref. Nr. Pro. 002/B/14 dt 13.02.2014.*) ARKEP ka përcaktuar brezet frekuencore për shërbimet përkatëse, për të cilat numri i autorizimeve është i kufizuar, ku në kuadër të tyre përfshihen edhe brezet 900MHz dhe 1800 MHz.

Plani Kombëtar i Radio Frekuencave, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (*Ref. Vendim Nr. 04-V-93*) ka përcaktuar që brezet frekuencore 900 MHz (880 -915 & 935 -960 MHz) dhe 1800 MHz (1710-1785 & 1805-1880 MHz) janë alokuar për shërbimet mobile IMT për nevoja të ofrimit të rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

ARKEP me Vendimin nr.1337 (*Ref. Nr.Prot.022/B/19*) ka miratuar Planet e shpërndarjes dhe shfrytëzimit te brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz:

- i. Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të radio frekuencave 880-915 & 925-960 MHz, për sistemet celulare tokësore GSM, UMTS, LTE , WiMAX dhe IoT;
- ii. Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të radio frekuencave 1710- 1785 & 1805 - 1880 MHz për sistemet celulare taksore GSM, UMTS, LTE , WiMAX dhe IoT.

ARKEP përmes dokumenteve të hartuara dhe publikuara në WEB faqen e tij si në vijim:

- Plani për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT "( Nr. Prot. 047/B/19 Dt. 08/05/2019),
- Dokumentit "Konkluzione nga këshillimi publik i dokumentit - Plani për hapjen e brezeve" (Nr. Prot. 048/B/19 Dt. 08/05/2019),

ka informuar palët e interesit lidhur me fazat dhe afatet për hapjen e brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, **përfshirë ripërtëritjen e autorizimeve individuale** për resurset ekzistuese në brezet 900 dhe 1800 MHz në shfrytëzim nga operatorët e Telekomit i Kosovës Sh. A. dhe IPKO Telecommunications LLC, i cili pritet të realizohet në gjysmën e parë të vitit 2019 sipas metodës së drejtpërdrejtë.

ARKEP me Vendimin nr.1401 (Ref. Nr.Prot. 065/B/19; dt 01/07/2019), pas procedurës së konsultimit publik me palët e interesit (Ref. Vendimi nr.1388; Nr.Prot.056/B/19) ka miratuar dokumentet:

- Konkluzionet e ARKEP për Ripërtëritjen e Autorizimeve Individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz për operatorët "Telekomi i Kosovës" Sh.A. dhe "IPKO Telecommunications" LLC.
- "Përgjigjet në Komentet e Operatorëve nga Këshillimi Publik i Dokumentit Ripërtëritjen e Autorizimeve Individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz për operatorët "Telekomi i Kosovës" Sh.A. dhe "IPKO Telecommunications" LLC.

Bazuar në dokumentet e mësipërme dhe marrë parasysh rekomandimin e konsulencës ndërkombëtare, ARKEP ka ardhur në përfundim se vlera e pagesës së njëhershme "One-Off" për resurset frekuencore për brezet 900 dhe 1800 MHz që do të jenë objekt i ripërtëritjes së autorizimeve individuale janë dhënë në tabelën në vijim.

**Tabela 1:** Çmimi i pagesës së njëhershme "one-off" për resurset frekuencore të shprehur në €/MHz/Pop.

Brezi frekuencor	Çmimi "On off" €/MHz/popullsia	Periudha kohore e Autorizimit
900 MHz	0.1410	15 vjet
1800 MHz	0.0705	15 vjet

Çmimi i spektrit frekuencore për periudhën 15 vjeçare llogaritet sipas formulës:

$$CS = C_{MHz/POP} \times BW_{MHz} \times P_{mbuluar}$$

CS- Çmimi i spektrit;  $C_{MHz/POP}$ - Vlera e spektrit prej 1 MHz për popullësi;  $P_{mbuluar}$ - numri i popullsisë Të vendit (sipas regjistrimit të fundit/të dhënave zyrtare nga ASK numri i popullsisë është 1,795,666<sup>1</sup>)

<sup>1</sup> <http://ask.rks-gov.net/media/4892/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2018.pdf>

Llogaritja e vlerës së spektrit frekuencore me kohëzgjatje të ndryshme nga periodha 15 vjeçare, pra për N vite ( $10 \leq N \leq 20$ ) kalkulohet sipas formulës:

$$Vlera\ e\ Spektrit_N = \frac{Vlera\ e\ Spektrit\ 15vjet}{\sum_{t=0}^{14} \left(\frac{1}{1+WACC}\right)^t} * \sum_{t=0}^{N-1} \left(\frac{1}{1+WACC}\right)^t$$

Operatorët përveç mundësisë së pagesës së përnjëhershme “one-off”, kanë pasur mundësinë që të përzgjedhin një nga opsionet e ndarjes në këste si më poshtë, për të cilin do të paguajnë normë interesi respektiv të dhënë në këtë tabelë në kolonën mesatarja e baraspeshuar.

**Tabela 2:** Normat e interesit për ndarjen në këste.

Instrumenti (Obligacioni)/ndarja në këste “D”	Norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar “i”(%)
Ndarja në këste 2 vjeçare	1.24507
Ndarja në këste 3 vjeçare	1.27999
Ndarja në këste 5 vjeçare	2.44155
Ndarja në këste 7 vjeçare	3.51486
Ndarja në këste 10 vjeçare	5.28238

Ndërsa për llogaritja e pagesës vjetore llogaritet sipas formulës në vijim.

Nëse autorizimi është për N vite dhe pagesa “one-off” do të bëhet sipas D - viteve për kohëzgjatjen e autorizimit (N vite), atëherë pagesa vjetore për vitin e parë llogaritet:

$$P1 = \frac{Vlera\ e\ Brezitet_D}{D}$$

Ndërsa pagesa në keestet tjera (D-1 këste të barabarta) llogaritet si në vijim:

$$Pagesa\ Vjetore = (Vlera\ e\ Brezitet_D - P1) * \frac{i}{1 - (1 + i)^{1-D}}$$

Ku i - është norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar e shprehur për D-1 vite.  
D - Numri i kësteve vjetore

Në përputhje me dokumentet e referuara më lartë, ARKEP ka kërkuar nga operatorët që deri me datë 15 Korrik 2019 të dorëzojnë aplikacionet dhe kërkesat për ripërtrirjen e autorizimeve dhe deri



më datë 25 korrik 2019 të konfirmojnë ndryshimet eventuale (Ref. E-mail: Wednesday, July 10, 2:02 PM).

Më datë 11 Korrik 2019 operatori IPKO Telecommunications LLC ka dërguar në ARKEP aplikacionin për ripërtrirjen e autorizimit (Ref. Nr.Prot.422/2/19) për kapacitetet ekzistuese në shfrytëzim në brezet 900 dhe 1800 MHz për periudhën 20 vjeçare dhe me pagesë në gjithësej 5 këste vjetore, prej nga rezulton se norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (në %) për këtë periudhë është 2.44155%.

Përcaktimi i blloqeve frekuencore në kufijtë dhe rangun e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore (edges frequency adjustment blocks) për brezet: 900 MHz dhe 1800MHz është bërë në përputhje me Planet e përdorimit të miratuar me Vendimin nr. 1337 (Ref. Nr.Prot.022/B/19).

Prandaj, marrë parasysh sqarimet e shpalosura si më lartë si dhe me qëllim të;

- Përmbushjes e prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara sipas politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të komunikimeve elektronike;
- Nxitjen e investimeve efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një kualitet më të lartë të produkteve të tyre.
- Plotësimin të kërkesave të ndërmarrësve/operatorëve për resurse frekuencore duke ofruar fleksibilitet, ndarja dhe efikasiteti në shfrytëzimin e resurseve frekuencore;
- Nxitjen e një konkurrence sa më efikase në tregun e komunikimeve elektronike; si dhe
- E drejta e shfrytëzimit të resurseve frekuencore mbi bazën e legjislacionit në fuqi, përfshirë, rregullat për dhënien, transferimin, rinovimin, modifikimin dhe tërheqjen e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve frekuencore, në mënyrë që të garantohet siguria, konsistenca dhe para shikueshmëria rregullatore.

Atëherë, Bordi i Autoritetit ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Këshilla Juridike;**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Prishtinë, 30/07/2019**

**Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi  
Kryetar i Bordit**

**Aktvendimi i dërgohet;**

- Operatorit, IPKO Telecommunications LLC;
- Departamenteve DMF, DKE, DRMI, DL dhe Zyrës së Financave
- Departamentit të Postë-Telekomunikacionit dhe Teknologjisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Arkivit, ARKEP



## SHTOJCA I

### Autorizimi Individual

për Vazhdimin e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz për operatorin IPKO Telecommunications LLC.

- 1) Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), autorizon dhe jep të drejtën e shfrytëzimit të resurseve frekuencore në brezin 900 dhe 1800 MHz Operatorit të telefonisë Mobile **IPKO Telecommunications LLC** (*tutje referuar si - Operatori*) sipas kushteve në vijim të këtij AUTORIZIMI me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike mobile tokësore brezgjëra - IMT, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- 2) Kapacitetet frekuencore të dhëna në shfrytëzim për operatorin dhe periodha kohore janë përcaktuar në tabelën në vijim:

*Tabela 1: Të dhënat për resurset frekuencore të përcaktuara për shfrytëzim për Operatorin "IPKO Telecommunications LLC"*

Brezi frekuencor	Kapacitetet e përcaktuar frekuencore (MHz)	Rangu i kapaciteteve frekuencore të dhëna për shfrytëzim	Periodha kohore	Intervali i vlefshmerisë së Autorizimit
900 MHz	2 x 10 MHz (20 MHz)	905 - 915 & 950 - 960 MHz	20 vite	07.03.2022 deri më 06.03.2042
1800 MHz	2 x 10 MHz (20 MHz)	1710 - 1720 & 1805 - 1815 MHz	20 vite	07.03.2022 deri më 06.03.2042
1800 MHz	2 x 10 MHz (20 MHz)	1720 - 1730 & 1815 - 1825 MHz	20 vite	31.07.2019 deri më 30.07.2039

- 3) Autorizimi Individual i specifikuar për operatorin, nuk mund të shitet, jepet me qera, të transferohet apo të jepet si garanci, pa miratimin paraprak nga ARKEP. Asnjë ndryshim i kontrollit të operatorit (Autorizuarit), qoftë i drejtëpërdrejt apo i tërthortë nuk mund të bëhet pa lejen paraprake me shkrim të ARKEP.
- 4) Obligohet Operatori që të zbatoj rekomandimet dhe standardet e CEPT-it, ETSI-it dhe ITU-së, të përshkruar në Planin e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të radio frekuencave për brezet 900 dhe 1800 MHz të aprovuara me Vendimin nr.1337 (*Ref. Nr.Prot.022/B/19*), dhe Planin Kombëtar të Radio frekuencave (*Ref. Vendim Nr. 04-V-93*).
- 5) Obligohet Operatori që brenda periudhës kohore prej tre (3) muajsh nga data e lëshimit të këtij autorizimi të bëjë korrigjimet eventuale të skajeve të blloqeve frekuencore në përputhje me paragrafin 2) të këtij Autorizimi.
- 6) Operatori përderisa ofron shërbime të komunikimeve elektronike vetëm brenda brezeve frekuencore 900 MHz dhe 1800 MHz nuk do të ketë obligime shtesë për mbulueshmëri.

Megjithatë Operatori duhet të siguroj se nuk do të ketë zvogëlim të mbulueshmërisë për territor dhe popullësi, si dhe degradim të kualitetit të shërbimeve. Pavarësisht kësaj, në rast të nevojave për mbulimin e zonave/hapësirave të caktuara me interes më të gjërë për konsumatorët ARKEP në çdo kohë mund të konsideroj si të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve.

- 7) Operatori duhet të siguroj se sistemi mobil tokësor nuk shkakëton interferencë të dëmshme, e cila rezulton në zvogëlimin e kualitetit ose operimin e rrjetave dhe/ose shërbimeve tjera të komunikimeve elektronike.
- 8) Operatori duhet të merr të gjitha masat dhe siguroj se sistemi mobil tokësor mund të bashkë-ekzistoj me sistemet aktuale dhe të ardhshme, të cilat operojnë në brezet fqinjë të radio spektrit frekuencor.
- 9) Obligohet Operatori që në emër të shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore prej 2x10 MHz në brezin 900 MHz dhe 2x20 MHz në brezin 1800 MHz të përcaktuara me këtë Autorizim të paguaj shumën prej **11,181,705.44 €** (Njëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesë euro e dyzet e katër cent), pa përfshirë normën e interesit si në tabelën në vijim:

**Tabela 2:** Vlera e pagesës bazë “One-Off “ për resurset frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz

Brezet frekuencore	Kapacitetet e percaktuar frekeuncore (MHz)		Çmimi “On off” €/MHz/popullsia	Periudhe kohor	Vlera financiare e resurseve frkeuncore
900 MHz	2 x 10 MHz	20 MHz	0.1410	20 vite	€ 5.590.852.72
1800 MHz	2 x 20 MHz	40 MHz	0.0705	20 vite	€ 5.590.852.72
<b>Gjthesej pagesa per kapacitet frekuencore ne brezet 900 dhe 1800 MHz</b>					<b>€ 11,181,705.44</b>

- 10) Operatorit i lejohe mundësia e pagesës me pesë (5) këste vjetore të çmimit “one-off” sipas normës së interesit të Obligacioneve të Thesarit të Republikës së Kosovës në vlerë prej 2.44155%.
- 11) Obligohet Operatori që në emër të shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore të përcaktuara me këtë Autorizim të paguaj këstet vjetore duke përfshirë normën e interesit si në tabelën në vijim:

**Tabela 3:** Vlera financiare me normë interesi resurseve frekuencore e ndarë për pagesë në 5 këste vjetore.

Viti	$\frac{i}{1 - (1 + i)^{1-D}}$	D	i	Pagesa e kësteve sipas viteve/Këstet (€)
1	0.265443706	5	2.44155%	<b>2,236,341.09</b>
2				2.374.490.66
3				2.374.490.66

4				2.374.490.66
5				2.374.490.66
12	<b>Pagesa në 10 këste (Totali)</b>			<b>11,734,303.74</b>

b

ligohet operatori që pagesën e kështit të parë në lartësi prej **2,236,341.09 €** (*dy milion e dyqind e tridhjet e gjashtë mijë e treqind e dyzet e një euro e nëntë cent*) të realizoj brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të faturave.

- 13) Pavarësisht paragrafit 11 të këtij autorizimi, Operatori ka të drejtë të paguaj shumën e mbetur të pagesës se njëhershëme "One off fee" të parapara për vitet e ardhshme me njoftim paraprak prej së paku 3 (tre) muajve para afatit të pagesës për kështin e radhës. Në këtë rast ARKEP nuk do të aplikoj normën e interesit për kështet e viteve të ardhshme, duke përjashtuar kështin e radhës pas marrjes së njoftimit.
- 14) Faturat për pagesat e kësteve do të lëshohen nga ARKEP më datë 30 Qershor të çdo viti.
- 15) Në rast se operatori nuk e përmbush obligimin për pagesë, atëherë ARKEP do të veproj si në vijim:
- Për çdo vonesë në pagesa do të aplikohet kamata ligjore prej 8% për shumën e faturuar;
  - Në qoftë se për dy vite me radhë operatori nuk i kryen pagesat e përcaktuara me këtë Vendim, ARKEP nëpërmjet procedurës së përmbartimit do të ekzekutoj tërë shumën e mbetur duke përfshirë normën e aplikuar të interesit.
- 16) Obligohet Operatori që të kryej pagesat vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio-frekuencave për kapacitete frekuencore ne shfrytëzim ne brezet 900 dhe 1800 MHz në përputhje me Rregulloren Nr. 35. Për "Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave" (Ref Nr. Prot. 005/ B/18; dt.19/ 01 /2018) dhe Nr. 22. për "Dhënie dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuencave" (Ref. Nr. Prot. 54/ B/13; dt.31/ 12 /2013).

Prishtinë, 30/ 07/ 2019

**Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**